

SHËRBIMI
GJEOLÓGJIK
I KOSOVËS
GEOLOGICAL SERVICE OF KOSOVO

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije /Ministry of Economy

REFERENCË:	Shkresa njoftuese		
PËR/ZA/TO:	Znj. Artane Rizvanolli, Ministre, ME		
CC:	Znj. Leonita Shabani- Mullarama, UD. Sekretare e përgjithshme, ME Znj. Anyla Beqa, Shefe e Kabinetit, ME		
PËRMES/PREKO/THROUGH:			
NGA/OD/FROM:	Luan Morina UD. Drejtor Ekzekutiv, SHGJK		
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti Vjetor i SHGJK-së - Viti 2023		
Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.:	Zyra Nr.1. UD. Drejtori Ekzekutiv i SHGJK-së	Lokacioni: Kucni: Extension:	SHGJK/ ME Data: 27.12.2023 Datum: Date:
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION			<input checked="" type="checkbox"/>
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL			<input checked="" type="checkbox"/>
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE			<input checked="" type="checkbox"/>
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION			<input checked="" type="checkbox"/>
AFATI/KRAJINI ROK/DEADLINE			

E nderuara znj. Ministre,

Përmes kësaj shkrese ju njoftoj se kam përgatitur Raportin Vjetor të punës së Shërbimit Gjeologjik të Kosovës për vitin 2023.

Ky raport është bazuar në bazë të realizimit të objektivave të planit të performances së SHGJK-së, përkundër sfidave që kemi pasur gjatë vitit 2023.

Në vijim të kësaj shkrese, keni raportin e detajuar.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije /Ministry of
Economy



SHËRBIMI
GJEOLGJIK
I KOSOVËS
GEOLOŠKA SLUŽBA KOSOVA
GEOLOGICAL SERVICE OF KOSOVO

RAPORTI VJETOR
bazuar në realizimin e objektivave të parapara me
Planin e performances për vitin 2023

(Periudha 01 Janar 2022 – 31 Dhjetor 2022)

1. Hyrje

Shërbimi Gjeologjik i Kosovës, bazuar në Ligjin për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, është agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë, ndërsa bazuar në Ligjin Nr. 06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, Rregulloren Nr.05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës është përgjegjëse për:

- 1.1 kryerjen e hulumtimeve themelore gjeologjike dhe hulumtimeve aplikative gjeologjike;
- 1.2. kryerjen e studimeve gjeologjike sistematike bazë në tokë, në liqene, nëpërmjet hartografimeve komplekse të shkallëve të ndryshme;
- 1.3. kryerjen e studimeve gjeokimike dhe përpilimin e hartave gjeologjike në shkallë të ndryshme, si dhe plotësimin e hartave ekzistuese me informacione të reja;
- 1.4. kryerjen e studimeve të thelluara shkencore për gjeologjinë dhe metalogjeninë;
- 1.5. kryerjen e studimeve dhe hulumtimeve gjeofizike të çdo shkalle me qëllim të studimit të korës së tokës në ose në afërsi të sipërfaqes së tokës;
- 1.6. kryerjen e studimeve për promovim të perspektivës së mineraleve të dobishme dhe vlerësimin ekonomik të tyre;
- 1.7. kryerjen e studimeve dhe hulumtimeve hidrogjeologjike, ujërave nëntokësore, ujërave minerale dhe gjeotermal;
- 1.8. kryerjen e studimeve dhe hulumtimeve gjeologo-inxhinierike dhe të gjeorreziqeve;
- 1.9. kryerjen e studimeve gjeologjike komplekse për gjeomjedisin në funksion të planifikimit të territorit;
- 1.10. kryerjen e studimeve dhe vlerësimeve të gjeomonumenteve;
- 1.11. kryerjen e hulumtimeve dhe vlerësimeve të mineraleve metalore, jo metalore, energjetike, hidrokarbureve, mineraleve industriale, gurët e çmuar dhe gjysmë të çmuar;
- 1.12. kryerjen e hulumtimeve dhe studimeve të përgjithshme paleontologjike, stratigrafike, sedimentologjike, petrografike, mineralogjike, kimike, gjeomorfologjike, gjeodinamike, gjeologjiko strukturore dhe gjeostatistike;
- 1.13. përpilimin apo plotësimin e hartave gjeologjike në shkallë të ndryshme, harta gjeologjike tematike (metalogenike, mineralmbajtëse, gjeokimike, hidrogjeologjike, gjeologo-inxhinierike,

strukturo-tektonike, sizmike, gjeomonumenteve, gjeoekologjike, përfshirë edhe përgatitjen e bazës gjeologjike për nevojat e planifikimit hapësinor, hulumtime dhe monitorimin e rrëshqitjeve të tokës, përgatitjen e hartave gjeologjike të rrezikut, hulumtimet regjionale gjeofizike, analiza dhe hulumtime laboratorike në fushat e mineralogjisë, petrografisë, sedimentologjisë, paleontologjisë, kimike, analiza gjeomekanike;

1.14. kryerjen e studimeve dhe punimeve zhvillimore, të hulumtimeve gjeo-shkencore dhe projekte ndërkombëtare në fushën e gjeologjisë, studimin e ujërave nëntokësore në bazë të programeve të veçanta, mbledhjen, përditësimin dhe ruajtjen e të dhënave dhe dokumentacionit teknik me interes për sistemin e bazës së të dhënave gjeologjike të Republikës së Kosovës;

1.16. krijimin, përditësimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave gjeologjike, e cila duhet të jetë në dispozicion të Qeverisë si dhe subjekteve të tjera të interesuara për hulumtime gjeologjike;

1.17. ofron analiza objektive dhe të paanshme për autoritetet publike dhe organizatat e sektorit privat brenda fushës së ekspertizës së SHGJK-së;

1.18. promovon kristalet e mineraleve, gurët e çmuar dhe gjysmë të çmuar të Muzeut Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve “Trepça”;

1.9. krijon, mirëmban, pasuron dhe zgjeron bazën shtetërore e të dhënave për kristalet dhe mineralet, fosilet, gurët e çmuar dhe gjysmë të çmuar;

1.10. hulumtime dhe studime mbi zvogëlimin e ndotjes së mjedisit nga aktivitetet minerare;

1.11. menaxhon me rrjetin Sizmologjik të Kosovës, monitoron aktivitetin sizmik të vendit dhe rajonit, bën studime makro dhe mikro sizmologjike sipas kodeve të aplikuara në Kosovë, si dhe detyra dhe përgjegjësi tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Raporti i Përformancës së Shërbimit Gjeologjik të Kosovës për vitin 2023, është hartuar bazuar në Planin Vjetor të Performancës së Shërbimit Gjeologjik të Kosovës për vitin 2023, i cili është i ndërlidhur drejtpërdrejt me Planin e Punës së Ministrisë së Ekonomisë, duke pas parasysh së Shërbimin Gjeologjik i Kosovës është agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë, dhe si rrjedhojë të gjitha objektivat që janë pjesë e këtij raporti, njëherësh janë pjesë edhe e Planit të Punës së Ministrisë Ekonomisë, kështu që performanca vjetore e Shërbimit Gjeologjik të Kosovës ka impakt të drejtpërdrejt në performancën vjetore të Ministrisë së Ekonomisë, përkatësisht në përmbushje e objektivave të përgjithshme të saj.

Të dhënat për hartimin e këtij raporti, janë mbledhur nga raportet e departamenteve përkatëse, përgjegjëse për përmbushjen e objektivave përmes aktiviteteve të planifikuara dhe të zhvilluara gjatë vitit 2023.

Po ashtu ky raport, është i fokusuar në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive të Shërbimit Gjeologjik të Kosovës, të përcaktuara me Ligjin për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, dhe sipas ndarjes së përgjegjësive të strukturave përkatëse, bazuar në Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës së Shërbimit Gjeologjik të Kosovës.

2. Objektivat dhe aktivitetet e planifikuara për vitin 2023

Në Planin e Performancës së Shërbimit Gjeologjik të Kosovës për vitin 2023, janë planifikuar gjithsej 5 objektiva të karakterit menaxherial, administrative dhe profesional, ku për secilin objektivi janë të planifikuar treguesit, aktivitetet përkatëse, kosto financiare përkatëse si dhe shpjegimet relevante.

Si rrjedhojë, për këtë periudhë raportuese, ky raport është i fokusuar në aktivitete e zhvilluara me qëllim të përmbushjes së objektivit përkatëse, përkatësisht:

1. Identifikimi dhe evidentimi i mëtejshëm i potencialit mineralogjik në zonën jugperëndimore të Republikës së Kosovës;
2. Monitorimi, evidentimi dhe vlerësimi i ngjarjeve që lidhen me Gjeorreziket;
3. Krijimi dhe digjitalizimi i të dhënave për rrjedhat lumore;
4. Promovimi dhe pasurimi i mëtejshëm me kristale/minerale i Muzeut Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve “Trepça”;
5. Ngritja e kapaciteteve teknike për analizat gjeologjike si dhe bashkëpunimi dhe mbështetja e aktiviteteve të karakterit zhvillimor në nivel vendor dhe ndërkombëtar.

3. Progresi në përmbushjen e objektivave dhe aktiviteteve përkatëse

Objektivi I - Identifikimi dhe evidentimin e mëtejshëm i potencialit mineralogjik në zonën jugperëndimore të Republikës së Kosovës - Pjesërisht i realizuar

Ky objektivi përbehet nga dy aktivitete, përkatësisht krijimin e Kadastrit të paraqitjeve xeherore të mineralit të kromit në njësinë tektonike të Sharrit si dhe Finalizimi i Planshetit të Ponoshecit në shkallë 1:25000.

- 1.1 Projekti : Krijimin e Kadastrit të paraqitjeve xeherore të mineralit të kromit në njësinë tektonike të Sharrit, është realizuar sipas planifikimeve për vitin 2023. Në vijimësi do të vazhdojnë punimet edhe në vitin 2024 – **i realizuar plotësisht**

- 1.2 Projekti: Planshetit të Ponoshecit, punimet fushore janë kryer, është në finalizim e sipër pjesa tekstuale dhe përgatitja e mostrave, për të vazhduar tutje me analiza përkatëse laboratorike. – **i realizuar pjesërisht**

Objektivi II- Monitorimi, evidentimi dhe vlerësimi i ngjarjeve që lidhen me Gjeorrezizet – i realizuar Plotësisht

Ne kuadër të këtij objektivi, të gjitha aktivitete janë realizuar sipas planifikimit paraprak.

- 2.1 Është finalizuar Harta Vjetore e shpërndarjes së intensitetit maksimal sizmik për vitin 2022, sipas legjisllacionit në fuqi, është proceduar përmes shkresë me nr. protokollit 1120 të datës 31.03.2023. — **i realizuar plotësisht**

Njëherë, sipas planifikimit është në proces finalizimi i Hartës përkatëse për vitin 2023 – që sipas obligimit ligjor pritet të finalizohet deri me TM1 2024.

- 2.2 Në vijimësi është zhvilluar procesi i monitorimit të rrëshqitjeve, dhe me këtë rast janë përgatitur 56 raport preliminarë rekomandues me masat për autoritetet përkatëse — **i realizuar plotësisht**

Objektivi III- Krijimi dhe digjitalizimi i të dhënave për rrjedhat lumore – Plotësisht i realizuar

Ne kuadër të këtij objektivi, të gjitha aktivitetet përkatëse janë përfunduar sipas planifikimit, ngase janë realizuar

- 3.1. studimet si në vijim:

- Studimi kimik dhe mineralogjik i sedimenteve të lumit Lepenc”
- Studimeve kimike dhe mineralogjike të sedimenteve të lumit Sitnica.
- Studimi kimik dhe mineralogjik i sedimenteve të lumit Drini i Bardhe
- Studimit Kimik dhe Mineralogjik të lumit Llap.

si dhe, njëherë është zhvilluar edhe

- 3.2 Krijimi i bazës së të dhënave për rrjedhat lumore
 - Data baza me të dhënat përkatëse për e gjithë lumenjtë e hulumtuar

Objektivi IV- Promovimi dhe pasurimi i metejmë me kristale/minerale i Muzeut Shtetror të Kristaleve dhe Mineraleve “Trepça” – Plotësisht i realizuar

Janë realizuar të gjitha aktivitetet e planifikuar për vitin 2023 me qëllim të përmbushjes së këtij objekti.

- 4.1 Janë evidentuar kristalet të cilat kanë humbur vlerën kristalore për shkak të oksidimit të tyre. Është pasuruar muzeu më kristale të reja siç është planifikuar, dhe po ashtu fondi i kristaleve të MSHKM “Trepça” është pasuruar edhe me kristale nga Australia dhe Sllovenia. Gjatë këtij viti,
- 4.2. MSHKM “Trepça” gjithashtu ka marr pjesë apo ka ekspozuar kristalet përkatëse në Konferencën Shkencore të mbajtur në UMIB, dhe ekspozimin e kristaleve në Muzeun Kombëtar të Kosovës, në kuadër të agjendës shtetërore për shënimin e ditës së minatorëve, epopesë së UÇK-së dhe shënimin e ditës së pavarësisë së Kosovës.

Objektivi V- Ngritja e kapaciteteve teknike për analizat gjeologjike dhe bashkëpunimi dhe mbështetja e aktiviteve e karakterit zhvillimor në nivel vendor dhe ndërkombëtar

Objektivi në fjale në vete përmban tre aktivitetet të cilat gjithashtu, janë realizuar sipas planifikimeve. Ne vijim informacioni relevant:

- 5.1. Projekti “Laboratori i IGJK” ka përfunduar dhe me këtë rast ne terma teknik mund te konstatohet se është bere funksionalizimi i pajisjeve laboratorike me qëllim të ngritjes se kapacitete teknike për ofrimin e shërbimeve për analiza mineralogjike, kimike, gjeomekanike dhe gjeofizike
- 5.2. Ne baze të raportimeve, janë duke u realizuar aktivite përkatës nga autoritet përkatës, përkatësisht kompania Terra LL.C , e cila ka marr per obligim Implementimi i memorandumit të mirëkuptimit për hulumtimin të ujërave nëntokësore
- 5.3. Janë realizuar të gjitha aktivitet e planifikuara per pjesëmarrje ne takimin e ftuara nga Shërbimi Gjeologjik Evropian (EGS) dhe është punuar tutje në përfshirjen e Kosovës, përkatësisht


të SHGJK-se në kuadër të projektit GSEU. Ky proces në bazë e kalendarit të aktiviteteve të EGS do të duhet të përfundoj me dakordim të gjithë pjesëmarrjeve në TM2 2024



4. Sfidat dhe hapat për adresimin e tyre



Në kuadër të përmbushjes së objektivave përkatëse, ndonëse ka pasur dhe ende ka sfida të ndryshme të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në përmbushjen e këtyre objektivave, konsiderohet si arritje dhe është për tu vlerësuar, niveli i lart i përmbushjes së Planit të Përformancës së SHGJK-së për vitin 2024. Përkundër këtyre kufizimeve për nga kapacitetet ekzistuese profesionale dhe teknike, shumica e objektivave janë përmbushur, mirëpo ka aktivitet të tillë, si psh. Plansheti i Ponošecit, që edhe pse janë ndërmarr veprimet e nevojshme dhe kanë përfunduar punimet fushore, mungesa e stafit profesional për punë specifike profesionale dhe mos funksionalizim më kohë i laboratorit me teknika dhe staf përkatës, kanë ndikuar që ky aktivitet nuk mund të konsiderohet i përfunduara.


Si rrjedhojë, sfiduese, ishte dhe mbetet, mungesa e stafit profesional, përkatësisht numri shumë i vogël i nëpunësve profesional, në krahasim më nevojat dhe planifikimet paraprake, për përmbushjen e mandatit dhe përgjegjësisve të përcaktuara më Ligjin për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës dhe legjislacionin në fuqi, andaj në planifikimin për vitin 2024, rekomandohet të kihet parasysh kapaciteti aktual profesional dhe teknik i stafit ekzistues, duke mos paragjykuar mundësit dhe planifikimet për rekrutim të stafit të ri dhe adekuat, sistemim të stafit ekzistues në pozita përkatëse profesionale bazuar në përgatitjen profesionale dhe përvojën e krijuar nderë vite, si dhe plotësimin e kushteve të punës dhe pajisjen me softuer përkatës të licencuar.

SHTOJCA II - Raporti Vjetor bazuar në Objektivat e Planin e Performancës për vitin 2023

Data:	27.12.2023						
AGJENCIA	Shërbimi Gjeologjik i Kosovës						
MINISTRIA PËRGJEGJËSE	Ministria e Ekonomisë						
Misioni Agjencisë	Misioni i Shërbimit Gjeologjik të Kosovës është kryerja e hulumtimeve gjeologjike, me qëllim të zbulimit dhe marrjes së informacioneve të duhura mbi ndërtimin gjeologjik, gjenezën, karakteristikat cilësore dhe sasore të mineraleve dhe resurseve tjera gjeologjike, karakteristikat gjeodinamike të mjedisit gjeologjik si rreziqet gjeologjike dhe rreziqet në kuptimin e aktivizimit të proceseve të rrezikshme gjeologjike, monitorimin e ngjarjeve sizmike, regjistrimin e tërmeteve dhe studimin e parametrave tërmetor, studimin e strukturës së kores së tokës etj.						
	Treguesi(t)	Vlera e synuar	Vlera faktike	Rezultatet (Autputet) e planifikuara	Rezultatet (Autputet) e përfunduara (Po/Jo)	Shënim shpjegues	Semafori
1. Identifikimi dhe evidentimi i mëtejshëm i potencialeve mineralogjike në zonën jugperëndimore të Republikës së Kosovës.	Kadastrri i krijuar në masën prej 90% të hapësirës së definuar për vitin 2023 në zonën e Sharrit, si dhe finalizimi në tersi (100%) i Planshetit të Ponoshecit në shkallën 1:25000.	47,586.00€	47,586.00€	1.1 Kadastrri i krijuar në masën prej 90% të hapësirës së definuar për vitin 2023.	PO –	Ky objektivi përbehet nga dy aktivitete, përkatësisht krijimin e Kadastrit të paraqitjeve xeherore të mineralit të kromit në njësinë tektonike të Sharrit si dhe Finalizimi i Planshetit të Ponoshecit në shkallë 1:25000. - 1.1 Projekti : Krijimin e Kadastrit të paraqitjeve xeherore të mineralit të kromit në njësinë tektonike të Sharrit, është realizuar sipas planifikimeve për vitin 2023. Në vijimësi do të vazhdojnë punimet edhe në	


				<p>1.2 Plansheti i Ponoshecit i finalizuar si tersi duke nënkuptuar edhe finalizimin e tekstit sqarues dhe krijimin e hartës përkatëse.</p>	JO	 <p>vitin 2024</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1.2 Projekti: Planshetti të Ponoshecit, punimet fushore janë kryer, është në finalizim e sipër pjesa tekstuale dhe përgatitja e mostrave, për të vazhduar tuje me analiza përkatëse laboratorike.
<p>2. Monitorimi, evidentimi dhe vlerësimi i ngjarjeve që lidhen me Gjeorrezizet</p>	<p>2.1 Finalizimi i hartës vjetore të shpërndarjes së intensitetit maksimal sizmik për vitin 2022 si dhe përpilimi i së paku 25 raporteve për monitorimin e rrëshqitjeve.</p>	<p>29, 375.59€</p>	<p>29, 375.59€</p>	<p>Është finalizuar dhe proceduar harta përkatëse, si dhe janë përpiluar 55 raporte për monitorimin e rrëshqitjeve.</p>	PO	 <p>Të gjitha aktivitetet janë realizuar sipas planifikimit paraprak.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Është finalizuar Harta Vjetore e shpërndarjes së intensitetit maksimal sizmik për vitin 2022, sipas legjislacionit në fuqi, është proceduar përmes shkresë me nr. protokolli 1120 të datës 31.03.2023. Njëherë, sipas planifikimit është ne proces finalizimi i Hartës përkatëse për vitin 2023 – që sipas obligimit ligjore pritet të finalizohet deri me TM1 2024. - Në vijimi është zhvilluar procesi i monitorimit e rrëshqitjeve, dhe me këtë rast janë përgatitur 56 raportet preliminare rekomanduese me masat për autoritetet

	3. Krijimi dhe digitalizimi i të dhënave për rrjedhat lumore	58,75.14€	58,75.14€	Dokumentacioni ekzistues historikë gjeologjikë i shqyrtuar në masën së paku prej 70%. Si dhe krijimi i data bazës dhe futja e të dhënave në masën prej së paku 70%.	Po	<p>përkatëse</p> <p>Sipas planifikimeve janë përfunduar të gjitha aktivitetet përkatëse si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kanë përfunduar studimet: <ul style="list-style-type: none"> 1. Studimi kimik dhe mineralogjik i sedimenteve të lumit Lepenc" 2. Studimeve kimike dhe mineralogjike të sedimenteve të lumit Sitnica. 3. Studimi kimik dhe mineralogjik i sedimenteve të lumit Drini i Bardhe 4. Studimit Kimik dhe Mineralogjik të lumit Llap. <p>Si dhe, njëherë është zhvilluar edhe Data baza me të dhënat përkatëse për e gjithë lumenjtë e hulumtuar</p>	
4. Promovimi dhe pasurimi i mëtejshëm me kristale/minerale i Muzeut Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve "Trepça".	Nga fondi ekzistues, trajtimi dhe restaurimi i së paku 30% si dhe pasurimi i mëtejshëm i muzeut me kristale dhe minerale të reja në masën prej së paku 10% dhe pritja dhe prezantimi me qellim të promovimit të ekzemplarëve të ekzpozuar në Muze para së paku 20 vizitave të realizuara nga vizitor të	25,656.72€	25,656.72€	Mirëmbajtja dhe pasurimi i mëtejshëm me kristale dhe minerale si dhe promovimi i tyre në vijimësi gjatë tërë vitit 2023. Si dhe prezantimi i mëtejshëm i kristaleve dhe	PO	<p>Janë realizuar të gjitha aktivitetet e planifikuara për vitin 2023 me qellim të përmbushjes së këtij objekti.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Janë evidencuar kristalet të cilat kanë humbur vlerën kristallore për shkak të oksidimit të tyre. Është pasuruar muzeu me kristale të reja siç është planifikuar, dhe po ashtu fondi i kristaleve të MSHKM 	

	ndryshëm.			mineraleve para së paku 20 vizitave të ndryshme në Muze si dhe pjesëmarrja në së paku 2 organizime/ evenimente tjera për qëllime të promovimit.		<p>“Trepça” është pasuruar edhe me kristale nga Australia dhe Sllovenia. Gjatë këtij viti,</p> <ul style="list-style-type: none"> - MSHKM “Trepça” gjithashtu ka marr pjesë apo ka eksponuar kristalet përkatëse në Konferencën Shkencore të mbajtur në UMB, dhe ekspozimin e kristaleve në Muzeun Kombëtar të Kosovës, në kuadër të agjendës shtetërore për shënimin e ditës së minatorëve, e popesë së UÇK-së dhe shënimin e ditës së pavarësisë së Kosovës. 	
<p>5. Ngritja e kapaciteteve teknike për analizat gjeologjike dhe bashkëpunimi dhe mbështetja e aktiviteteve e karakterit zhvillimor në nivel vendor dhe ndërkombëtar ..</p>	<p>Deri në mes të vitit (TM2 2023) të gjitha kapacitetet teknike për analiza gjeologjike në SHGJK të funksionalizuara, si dhe deri në fund të vitit (TM4) të kemi përfaqësim përmbajtësor në së paku deri në 80% të gjitha aktiviteteve/ evenimenteve të karakterit zhvillimor të organizuara nga Shërbimi Gjeologjik i Evropës (EGS).</p>	<p>391,099.00 €</p>	<p>391,099.00 €</p>	<p>Kapacitetet teknike të SHGJK-së funksionale. Pjesëmarrja në takimet e EGS-së përfaqësim përmbajtësor.</p>	<p>Po apo JO</p>	<p>Ky objektiva tre aktivitetet te cilat gjithashtu, janë realizuar sipas planifikimeve</p> <ul style="list-style-type: none"> - 5.1. Projekti “Laboratori i IGJK” ka përfunduar dhe me këtë rast ne terma teknik mund te konstatohet se është bere funksionalizimi i pajisjeve laboratorike me qëllim të ngritjes se kapacitete teknike për ofrimin e shërbimeve për analiza mineralogjike, kimike, gjeomekanike dhe gjeofizike - 5.2. Ne baze të raportimeve, 	

							<p>janë duke u realizuar aktivitetet përkatës nga autoritetet përkatës, përkatësisht kompania Terra L.L.C, e cila ka marr per obligim Implementimi i memorandumit të mirëkuptimit për hulumtimin të ujërave nëntokësore</p> <p>5.3. Janë realizuar të gjitha aktivitetet e planifikuara per pjesëmarrje ne takimin e ftuara nga Shërbimi Gjeologjik Evropian (EGS) dhe është punuar tuje në përfshirjen e Kosovës, përkatësisht të SHGJK-se në kuadër te projektit GSEU.</p> <p>Ky proces në bazë e kalendarit të aktiviteteve të EGS do të duhet të përfundoj me dakordim të gjithë pjesëmarrjeve në TM2 2024</p>
--	--	--	--	--	--	--	--

Drejtori i Agjencisë



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E EKONOMISË / MINISTARSTVO EKONOMIJE / MINISTRY OF ECONOMY

Shërbimi Gjeologjik i Kosovës/ Geološka Sluzba za Kosovo/ Geological Survey of Kosovo

REFERENCË:	SHKRESE PËRCJELLËSE		
PËR/ZA/TO:	Znj. Artane Rizvanolli, Ministre, ME <i>Mirëkëmbur 30.12.2022</i>		
CC:	Znj. Leonita Shabani, Zëvendës Sekretare e Përgjithshme, ME Znj. Anyla Beqa, Shefe e kabinetit, ME		
PËRMES/PREKO/THROUGH:			
NGA/OD/FROM:	Luan Morina, Zëvendës Drejtor Ekzekutiv, Shërbimi Gjeologjik i Kosovës, ME <i>Mirëkëmbur</i>		
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Planin e Performancës së Shërbimit Gjeologjik të Kosovës për vitin 2023		
Nr. i zyrës:	01	Lokacioni:	SHGJK
Br. kancelarije:		Kuceni:	
Room No.:		Extension:	
		Data:	22.12.2022
		Datum:	
		Date:	
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION			<input checked="" type="checkbox"/>
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL			<input checked="" type="checkbox"/>
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE			<input type="checkbox"/>
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS			<input type="checkbox"/>
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY WE DISCUSS			<input type="checkbox"/>
VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION			<input checked="" type="checkbox"/>
SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED			<input type="checkbox"/>
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED			<input type="checkbox"/>
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN			<input type="checkbox"/>
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION			<input checked="" type="checkbox"/>
AFATI/KRAJINI ROK/DEADLINE			31.12.2022

E nderuara Ministre Rizvanolli,

Përmes kësaj shkrese ju njoftoj se Shërbimi Gjeologjik i Kosovës, ka hartuar Planin e Performancës së Shërbimit Gjeologjik të Kosovës për vitin 2023, duke u bazuar në

Rregulloren (QKR) nr.03/2020 për Performancën e Agjencive, e cila buron nga Ligji Nr. 06/1-133 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura.

Në vijim keni:

Planin e Performancës së Shërbimit Gjeologjik të Kosovës për vitin 2023

PLANI I PERFORMANCËS SË SHËRBIMIT GJEOLJIK TË KOSOVËS PËR VITIN 2023

B. Pjesa tabelare e Planit të Përfundimit të Shërbimit Gjeologjik të Kosovës - Viti 2023

Nr.	Objektivat, treguesit dhe detyrat	Vlera bazë (baseline)	Caku			
I.	Objektivi 1: Identifikimi dhe evidentimi i mëtejshëm i potencialeve mineralogjike në zonën jugperëndimore të Republikës së Kosovës					
1	Treguesi i performancës: Kadastrat i krijuar në masën prej 90% të hapësirës së definuar për vitin 2023 në zone e Sharrit si dhe finalizimi në tersi (100%) i Planshetit të Ponoshecit në shkallën 1:25000	TM4 2023				
Nr.	Aktiviteti	Drejtoria përgjegjëse	Afati i zbatimit	Buxheti ¹	Burimi i financimit	Produkti (Output)
1.1	Krijimi i kadastrit të paraqitjeve xeherore të mineralit të kromit në njësinë tektonike të Sharrit	Departamenti i Gjeologjisë Regionale	TM1-TM4 2023	23,793.00	BRK	Kadastrat i krijuar në masën prej 90% të hapësirës së definuar për vitin 2023 e të paraqitjeve xeherore të mineralit të kromit në njësinë tektonike të Sharrit
1.2	Finalizimi i Planshetit të Ponoshecit, në shkallë 1: 25000	Departamenti i Gjeologjisë Regionale	TM1-TM4 2023	23,793.00	BRK	Planshetit të Ponoshecit e finalizuar si tersi duke nënkuptuar edhe finalizimin e tekstit sqarues dhe krijimi i hartës përkatëse të Ponoshecit
Buxheti i përgjithshëm për Objektivin 1:				47,586.00	BRK	

¹ Buxheti është i përafërt // është kalkuluar duke marrë në konsideratë pagat e zyrtareve dhe derivate e shpenzuara për realizimin e aktivitetit në fjalë dhe do të mbulohen nga planifikimet e rregullta për paga dhe buxheti i alokuara në vitin 2023 në kategorinë mallra dhe shërbime. Prandaj, nuk pritet buxhet shtesë përtej planifikimeve të rregullta buxhetore.

PLANI I PERFORMANCËS SË SHËRBIMIT GJEOLGIK TË KOSOVËS PËR VITIN 2023

Nr.	Objektivat, treguesit dhe detyrat	Vlera bazë (baseline)	Caku			
II. Objektiv 2: Monitorimi, evidentimi dhe vlerësimi i ngjarjeve që lidhen me Gjeorrezikët						
1	Treguesi i performances: Finalizimi i hartës vjetore të shpërndarjes së intensiteti maksimal sizmik për vitin 2022 si dhe përpilimi i së paku 25 raporteve për monitorimin e rrëshqitjeve	TM4 2023				
Nr.	Aktiviteti	Drejtoria përgjegjëse	Afati i zbatimit	Buxheti ²	Burimi i financimit	Produkti (Output)
1.1	Monitorimi dhe mirëmbajta i rrjetit sizmik dhe përpilimi i hartës vjetore të shpërndarjes së intensiteti maksimal sizmik	Departamenti të Gjeoinformacionit dhe Gjeoteknikës	TM1-TM4 2023	13,062.36	BRK	Finalizimi i hartës vjetore të shpërndarjes së intensiteti maksimal sizmik për vitin 2022 si dhe Monitorimi në vijimësi dhe vizita e së paku 2 herë të stacioneve sizmike me qëllim të mirëmbajtës së tyre
1.2	Monitorimi dhe vlerësimi i rrëshqitjeve	Departamenti të Gjeoinformacionit dhe Gjeoteknikës	TM1-TM4 2023	16,313.23	BRK	Monitorimi dhe vlerësimi i rrëshqitjeve në së paku 25 lokacione dhe përgatitja e raporteve për rekomandim të masave përkatëse
Buxheti i përgjithshëm për Objektivin 2:				29,375.59	BRK	

² Buxheti është i përafërt // është kalkuluar duke marrë në konsideratë pagat e zyrtareve dhe derivate e shpenzuara për realizimin e aktivitetit në fjalë dhe do të mbulohet nga planifikimet e rregullta për paga dhe buxheti i alokuara në vitin 2023 në kategorinë maltra dhe shërbime. Prandaj, nuk pritet buxhet shtese përtej planifikimeve të rregullta buxhetore.
Faqe 15 nga 18

PLANI I PERFORMANCËS SË SHËRBIMIT GJEOLJIK TË KOSOVËS PËR VITIN 2023

Nr.	Objektivat, treguesit dhe detyrat	Vlera bazë (baseline)	Caku			
III.	Objektivi 3: Krijimi dhe digjitalizimi i të dhënave për rrjedhat lumore					
1	Treguesi i performances: Analizimi dhe krijimi i data bazës përkatëse për futjen e të dhënave në masën së paku prej 70%	TM4 2023	x			
Nr.	Aktiviteti	Drejtoria përgjegjëse	Afati i zbatimit	Buxheti ¹	Burimi i financimit	Produkti (Output)
1.1	Evidentimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit ekzistues gjeologjik dhe hidrogjeologjik për rrjedhat lumore	Departamenti i Sedimentologjise	TM1-TM4 2023	2,966.82	BRK	Dokumentacioni ekzistues historikë gjeologjikë i shqyrtuar në masën së paku prej 70%
1.2	Krijimi i bazës së të dhënave për rrjedhat lumore	Departamenti i Sedimentologjise	TM1-TM4 2023	2,908.32	BRK	Krijimi i data bazës dhe futja e të dhënave në masën prej së paku prej 70%
	Buxheti i përgjithshëm për Objektivin 3:			5,875.14	BRK	

¹ Buxheti është i përafërt // është kalkuluar duke marrë në konsideratë pagat e zyrtareve dhe derivate e shpenzuara për realizimin e aktivitetit në fjalë dhe do të mbulohen nga planifikimet e rregullta për paga dhe buxheti i alokuara në vitin 2023 në kategorinë mallra dhe shërbime. Prandaj, nuk pritet buxhet shtesë përtej planifikimeve të rregullta buxhetore.
Faqe 16 nga 18

PLANI I PERFORMANCËS SË SHËRBIMIT GJEOLJIK TË KOSOVËS PËR VITIN 2023

Nr.	Objektivat, treguesit dhe detyrat	Vlera bazë (baseline)	Caku			
IV. Objektivi 4: Promovimi dhe Pasurimi i mëtejshëm me kristale /minerale i Muzeut Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve "Trepça"						
1	Treguesi i performances: Nga fondit ekzistues, trajtim dhe restaurimit i së paku 30 % si dhe pasurimi i mëtejshëm i muzeut me kristaleve dhe minerale të reja në masën prej së paku 10% si dhe pritja dhe prezantimi me qëllim të promovimit të ekzemplarëve të ekspozuara në Muze para së paku 20 vizitave të realizuara nga vizitor të ndryshme	TM4 2023	x			
Nr.	Aktiviteti	Drejtoria përgjegjëse	Afati i zbatimit	Buxheti ⁴	Burimi i financimit	Produkti (Output)
1.1	Mbledhja, trajtimi dhe restaurimi i kristaleve/mineraleve për qëllime të ekspozimeve të tyre;	Muzeut Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve "Trepça,	TM1-TM4 2023	12,569.28	BRK	Mirëmbajtja dhe pasurimi i mëtejshëm me kristale dhe minerale si dhe promovimi i tyre në vijimësi gjatë tërë vitit 2023.
1.2	Prezantimi i kristaleve/mineraleve në Muzeut Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve "Trepça, si dhe bashkëpunimi ndërinstitucionalë për qëllime të promovimit të mëtejshëm të tyre	Muzeut Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve "Trepça,	TM1-TM4 2023	13,087.44	BRK	Prezantimi i mëtejshëm i kristaleve dhe mineraleve para së paku 20 vizitave të ndryshme në Muzeun si dhe pjesëmarrja në së paku 2 organizime/ evenimenteve tjera për qëllime të promovimit.
Buxheti i përgjithshëm për Objektivin 4:				25,656.72	BRK	

⁴ Buxheti është i përafërt // Është kalkuluar duke marrë në konsideratë pagat e zyrtareve dhe derivate e shpenzuara për realizimin e aktivitetit në fjalë dhe do të mbulohej nga planifikimet e rregullta për paga dhe buxheti i alokuara në vitin 2023 në kategorinë mallra dhe shërbime. Prandaj, nuk pritet buxhet shtesë përtej planifikimeve të rregullta buxhetore.
Faqe 17 nga 18

PLANI I PERFORMANCËS SË SHËRBIMIT GJEOLJIK TË KOSOVËS PËR VITIN 2023

Nr.	Objektivat, treguesit dhe detyrat	Vlera bazë (baseline)	Caku			
V.	Objektivi V: Ngritja e kapaciteteve teknike për analizat gjeologjike si dhe bashkëpunimi dhe mbështetja e aktivitetet e karakterit zhvillimore në nivel vendore dhe ndërkombëtar					
1	Treguesi i performances: Deri në mes të vitit (TM2 2023) të gjitha kapacitete teknike për analiza gjeologjike në SHGJK të funksionalizuara, si dhe deri në fund të vitit (TM4) të kemi përfaqësim përmbajtësorë në së paku deri në 80% të gjitha aktiviteve/ evenimenteve të karakterit zhvillimore te organizuara nga Shërbimi Gjeologjik i Evropës (EGS)	TM4 2023				
Nr.	Aktiviteti	Drejtoria përgjegjëse	Afati i zbatimit	Buxheti ³	Burimi i financimit	Produkti (Output)
1.1	Ngritja e kapaciteteve teknike për analizat gjeologjike	Të gjitha departamentet	TM1-TM4 2023	361,099.00	BRK	Kapacitetet teknike të SHGJK funksionale
1.2	Mbështetja e aktivitetet të karakterit zhvillimore, në nivel vendore dhe ndërkombëtar	Të gjitha departamentet	TM1-TM4 2023	30,000.00	BRK	Pjesëmarrja në takimet e EGS-së përfaqësim përmbajtësore
	Buxheti i përgjithshëm për Objektivin 5:			391,099.00	BRK	

³ Buxheti është i përafërt // është kalkuluar duke marrë në konsideratë obligimet që barten nga viti 2022 për realizimin e projektit për funksionalizimin e pajisjeve laboratorike si dhe pagat e zyrtareve. Ky buxhet do të mbulohet kryesisht nga kategoria kapitale si dhe nga buxheti sipas planifikimeve të rregullta për paga dhe buxheti i alokuara në vitin 2023
Faqe 18 nga 18